



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 51
Prishtinë, më 13 shkurt 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme dhe anëtarët e Komisionit për Stabilizim- Asociim: z. Elmi Reçica, z. Cerim Bajrami, z. Ismet Beqiri, znj. Puhie Demaku, z. Pal Lekaj, z. Xhavit Haliti, z. Sabri Hamiti, z. Muhamet Mustafa dhe znj. Donika Kadaj Bujupi.

Delegacioni i Grupin Britanik të Unionit Ndërparlamentar ishte në përbërje nga: z. Martin Vickers, udhëheqës i delegacionit, me deputetët z. Nic Dakin-deputet, z. Andrew Rosindell, znj. Baronessa Barker, dhe z. Earl of Sandwich.

Nga Zyra e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Komisionit për Stabilizim -Asociim: Minire Hasani, Ariana Musliu dhe Filloreta Kabashi.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu –EUSR/EU Office, Lumnije Murati- ZPRK, Kaltrina Beqiri –Praktikane dhe Gurjeta Zeka-LVV.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Komisionit për Stabilizim- Asociim me Grupin Britanik të Unionit Ndërparlamentar.

Xhavit Haliti theksoi se është kënaqësi të takohemi me përfaqësues të popullit të Britanisë së Madhe, nga e cila gjithnjë kemi pasur mbështetjen dhe vazhdojmë të jemi të interesuar që të kemi bashkëpunim, në të gjitha fushat. Njoftoi se në këtë takim janë të pranishëm anëtarët e dy komisioneve parlamentare atë të Komisionit për punë të jashtme dhe të Komisionit për stabilizim-asociim.

Z. Haliti theksoi se Kosova ka nevojë për bashkëpunim në të gjitha fushat e në veçanti të krijojë raporte bashkëpunimi në mes të kuvendeve. Më tej tha se përvoja e shtetit të Kosovës nuk është e gjatë në demokracinë parlamentare dhe në këtë drejtim po bëjmë përpjekje që të marrim përvojat më të mira nga vendet perëndimore dhe nga Britania e Madhe edhe pse kemi një strukturë tjetër organizative. Z. Haliti e njoftoi delegacionin edhe për strukturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Elmi Reçica i prezantoi anëtarët e Komisionit për punë të jashtme. Këtë takim tha se e konsideron shumë të rëndësishëm, e po ashtu edhe këmbëngulësinë e Britanisë së Madhe për ta mbështetur Kosovën në të gjitha periudhat e konsideron shumë të rëndësishme. Njoftoi për angazhimet e Komisionit për punë të jashtme në mbikëqyrjen e procesit të dialogut me Serbinë të mbështetur nga organizata joqeveritare, KDI, si dhe për angazhimet e tjera. Z. Reçica theksoi se Kosova si një shtet i ri, ka nevojë për mbështetje në procesin e integrimi në institucione rajonale e ndërkombëtare.

z. **Martin Vickers**, udhëheqës i delegacionit, njoftoi se në këtë takim janë të pranishëm deputetë të dy dhomave të Parlamentit. Duke parë interesimin e Kosovës që të jetë pjesë e BE-së, theksoi se janë të interesuar që të fuqizojnë marrëdhëniet me Kosovën dhe ta ndihmojnë atë në ofrimin me BE-në. Z. Vickers theksoi se janë të interesuar që të forcojnë raportet ekonomike dhe të ndihmojnë në zhvillimin e ekonomik të Kosovës.

Andrew Rosindell, lidhur me sistemin rregullator të Britanisë së Madhe, tha se kanë katër zona zgjedhore. Jemi shteti i cili ka mbështetur popullin e Kosovës dhe se do ta ndihmojë edhe në të ardhmen, tha ai. Njoftoi se Britania e Madhe ka vendosur të dalë nga BE-ja dhe tani gjenden në fazën e tranzicionit në këtë drejtim, por se janë pjesë e Evropës. Z. Rosindell tha se ne do të kemi marrëdhënie bilaterale dhe do ta ndihmojmë njëri-tjetrin në aspektin e bashkëpunimit. Ai pyeti se në cilat fusha duhet të punojmë e të bashkëpunojmë që të fuqizohen marrëdhëniet në mes të dy vendeve.

Xhavit Haliti sa i përket ndihmës dhe bashkëpunimit me Britaninë e Madhe, tha se Kosova ka nevojë për krijimin e kushteve më të favorshme për studentët tanë që studiojnë atje, e po ashtu ka nevojë për ndihmë në zhvillimin ekonomik. Bëri të ditur se fuqia punëtore në Kosovë është shumë e lirë dhe se ka mundësi për investime në Kosovë.

Muhamet Mustafa theksoi se është i rëndësishëm për Kosovën vazhdimi i bashkëpunimit me Britaninë e Madhe. Si prioritet në fushën e bashkëpunimit tha se do të ishte e nevojshme ngritja e projekteve të përbashkëta për ngritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë. Është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi në sferën e tregtisë, i cili tani për tani është simbolik, por ka mundësi të rritet. Z. Mustafa tha interesi i kompanive britanike ka qenë për miniera dhe se me ligjin për investime strategjike, do të krijohet mundësia e bashkëpunimit edhe në shumë sfera të tjera.

Baronesha Barker, mes tjerash në diskutimin e saj, tha se faktori kryesor për mirëqenie dhe investime të një shoqërie, është siguria e gjinisë femërore dhe e komunitetit pakicë dhe pyeti nëse ka kriza në këtë drejtim.

Donika Kadaj- Bujupi, mes tjerash, tha se në vendin tonë janë dy çështje kryesore që lidhen me mungesën e zhvillimit dhe integritet, qoftë të pakicave apo të një prosperiteti të përgjithshëm. Sfidat me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë e kanë bazën në mungesën e sundimit të ligjit. Sa i përket zhvillimit ekonomik tha se ai bazohet kryesisht në dogana, nuk kemi prodhim, jemi shoqëri

konsumuese dhe kjo në të gjitha raportet ndërkombëtare është sfidë, që e rritë krizën në vend. Ajo theksoi po ashtu se në Kosovë ka dështim të gjykatave prokurorisë e policisë dhe se investimet janë shumë modeste.

Qerim Bajrami theksoi se Britania e Madhe është një faktor i rëndësishëm për shtetin e ri të Kosovës. Sa i përket komuniteteve të tjera në Kosovë, tha se ato kanë pozitë të mirë sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës. Ne, si komuniteti boshnjak, po ashtu edhe ai turk e kemi të drejtën e shkollimit në gjuhën tonë amtare, sipas planeve e programeve mësimore të Republikës së Kosovës, bëri të ditur z. Bajrami.

Earl of Sandwich tha se është e rëndësishme që edhe pse Britania e Madhe po largohet nga BE, ne do ta mbështesim Kosovën. Kërkoj të informohet më hollësisht lidhur me dialogun dhe trenin.

Xhavit Haliti duke u ndërlidhur me pyetjen e deputetit britanik, theksoi se institucionet janë të vendosura që në përputhje me domosdoshmërinë e dyja vendeve që të integrohen në BE dhe për t'i harmonizuar çështjet kontestuese, ta vazhdojnë dialogun. Serbia është një shtet që ka propagandën shumë të zhvilluar krahasuar me Kosovën, ndërsa çështja e trenit ishte një provokim nga ajo, theksoi z. Haliti. Lidhur me situatën për trenin njoftoi delegacionin britanik se policia e Kosovës ka ndërmarrë masat e duhura sipas ligjeve të Kosovës dhe fatmirësisht edhe Serbia nuk ka insistuar që treni të vijë deri aty ku e ka pasur destinacionin.

Pal Lekaj sa i përket bashkëpunimit tha se duhet të zhvillojmë bashkëpunim bilateral me Britaninë e Madhe në fushën ekonomike, në diplomacinë parlamentare dhe demokratizimin e partive politike me programe të sakta çfarë është edhe përvoja britaneze. Njoftoi se si opozitë kanë pasur kundërshtime e vërejtje lidhur me dialogun, nga se Kosova pak ka përfituar nga ky dialog, duke theksuar se duhet të kemi një platformë të saktë të bisedimeve e cila do të ishte në dobi të dy vendeve. Z. Lekaj tha se Serbia nuk është e interesuar për paqe në Ballkan, si dhe trajtimi i qytetarëve të Kosovës nga Serbia siç është rasti me z. Haradinaj, është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në sovranitetin e Kosovës, që mund ta destabilizoj vendin e rajonin.

Sabri Hamiti tha se muri në Mitrovicë, treni provokues i nisur për Kosovë, fletarrestit për z. Haradinaj janë momente në politikë, që Serbia në mënyrë konsekuente i udhëheq ndaj Kosovës për ta destabilizuar atë. Për tejkalimin e këtyre raporteve janë duke u zhvilluar bisedimet më se 5 vjet dhe janë arritur shumë marrëveshje, por disa nga ato ende nuk zbatohen, tha ai. Sa i përket komuniteteve të tjera tha se me Kushtetutë u kemi dhënë të drejta deri në nivel të vetos, që në njëfarë mënyre e kemi sjellë një lloj bllokade në Kosovë dhe tani ky komunitet përmes asociacionit tenton të shtrijë një pushtet të tretë, tha z. Hamiti.

Puhie Demaku tha se shumica e kohës së Qeverisë është e koncentruar për bisedime. Sa i përket dialogut theksoi se opozita është për një dialog me parime dhe principe. Dialogu i zhvilluar deri më tani, ka përfunduar pa kohë të zgjatjes dhe pa kushte. Znj. Demaku po ashtu theksoi se Kosova ende nuk ka liberalizim të vizave.

Andrew Rosindell theksoi se Serbia është duke u munduar ta pengojë zhvillimin e Kosovës. Krijimit të një shoqërie i nevojitet kohë e gjatë, duhet të luftoni për të drejtat që u takojnë dhe të ndërtoni shoqërinë tuaj, tha z. Rosindell. Ai po ashtu theksoi se janë të gatshëm që të ndihmojnë në ndërtimin e strukturave institucionale në Kosovë.

Elmi Reçica, duke falënderuar delegacionin për takimin, kërkoi që të ndikojnë tek e vendet e treta me qëllim të bashkëpunimit parlamentar, njohjeve të reja të shtetësisë së Kosovës, si dhe për aktivitete të tjera ndërmjet parlamenteve.

Martin Vickers, theksoi se janë të gatshëm të ndihmojnë Kosovën në çdo fushë të jetës, edhe pse do të largohen nga BE, do ta mbështesin atë.

Xhavit Haliti në përmbyllje të takimit, falënderoi delegacionin për takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica